



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIMI
Nr.04 datë 17.02.2025

Mbi "Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Xhevahir Kol Gjoka i dëmtuar nga erërat me intesitet të lartë të dt.12.01.2025 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016.

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga erërat e dt.12.01.2025 në banesën e shtetasit **Xhevahir Kol Gjoka** që është banorë i Qytetit Vau Dejës të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës , për familjen e **z.Xhevahir Kol Gjoka** në vlerën totale të dëmit **96.000** (Nëntëdhjete e gjashtë mijë) lekë.
2. Të miratojë dhënien e kompensimit sipas proces verbalit të vlerësimit i hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën **50%** të vlerës totale në shumën **48.000** (katerdhjete e tetë mijë) lekë.
3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Burimi i financimit do të jetë fondi i buxhetit të Bashkisë i miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.84 dt.23.12.2024 konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 860/1 dt.06.01.2025 .

Konfirmoi bazen ligjore

Harimë Deda

Konfirmoi bazen financiare

Ebe Rrelle

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Valjeta Nikaj

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

Aleksandra GJONI



Objekti: "Ndërtese (banesë) 2(dy) katëshe me çati në pronësi të z. Xhevahir Kol Gjoka

Vendodhja: Qyteti Vau Dejës, me nr.pasurie 2 / 32 (ASIG) ZK.8598 , Njesia Administrative Vau Dejës , Bashkia Vau-Dejes

Bazuar në urdhrin e punës të ngritur nga titullari i bashkisë Vau Dejës me nr. 31 datë 22.01.2025, grupi i punës verifikoi gjendjen në banesën e z. **Xhevahir Gjoka**.

Banesa ndodhet në Qytetin Vau Dejës (rruga Gjeraldo Tushi) të Njesisë Administrative Vau Dejës, në zonën kadastrale 8598 me nr.pasurie 2/32(ASIG). Shtetasi **Xhevahir Gjoka** nuk disponon certifikatë pronësie për këtë objekt, por që ka aplikuar për legalizim (ndërtim informal) pranë ASHK ku me dt.26.01.2025 ka bërë riaplikim për të parë statusin e aplikimit nga ASHK.

Gjatë inspektimit në terren u kryen verifikimi i banesës që është dëmtuar nga erërat me intensitet të lartë të dt.12.01.2025 nga ku rezultoi së është zbuluar pjesërisht ndërtesa prej 40 m² (Çati me tjegulla mars) , Banesa është e ndërtuar në vitin 1980 e mbuluar me tjegull marsejeze. Në vlerësimin e dëmëve të objektit, janë marrë parasysh çmimet e referencës nga shkresa e Drejtorisë së Enti Kombëtar i Banesave me Nr.287 prot dt.14.02.2017 si dhe në përzgjedhja e zërave të punës është bërë në mënyrë të tillë, që objekti të rikthehet në gjendjen e saj fillestare, para se të përfshihej nga dëmtimi.

Emertimet e zërave te punës (dëmtimet)	Siperfaqja
Çati me tjegulla mars, KD h.d-6 m lluster/pa lluster	40 m ²

Punoi : Lazer Gjergji



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau Dejës, me 23.01.2025

PROCES VERBAL KONSTATIMI

I Mbajtur sot me datë **23.01.2025** në Qytetin Vau Dejes të Njësisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë **Nr.31 dt.22.01.2025** për konstatimin e kërkesës me nr praktike 72 dt.14.01.2025 të shtetasit **Xhevahir Kol Gjoka** mbi dwtimet nga erwrat me intensitet tw lartw në banesën e tij me dt.12.01.2025.

Gjatë verifikimit në vend u konstatua:

Banesa është ndërtesë 2(dy) katëshe me çati e mbuluar me tjegull marsejeze e ndërtuar në vitin 1980 ku është zbuluar sipërfaqja e pjesshme e banesës prej 40 m².

Ererat me intensitet te larte te dt.12.01.2025 kanë zbuluar pjesërisht çatinë e shtetasit **Xhevahir Gjoka** ku fatmirësisht nuk ka humbje jetësh. Në banesë nuk jane demtuar mobileritë, orendite dhe pajisjet elektroshtëpiake.

Nr	Emertimi	Sasia m ²
1	Tjegull marsejeze	40
	Totali	40

Bashkëlidhur këtij proces verbali do të gjeni edhe kopjen e relacionit teknik të shtetasit **Xhevahir Gjoka** banor në Qytetin Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës.

Valjeta Nikaj

KOMISIONI

Lazer Gjergji

Ardian Firza

MIRATO HET
KRYETARI
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI
Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 23.01.2025

MIRATOHET

KRYETARI
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Aleksandra GJONI

Vlerësimi i dëmeve në mobileri, orendi, pajisje elektroshtepiake

Në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për dëmtimet nga ererat e dt.12.1.2025 në banesën e shtetasit **Xhevahir Kol Gjoka**.

Vlerësimi i zërave të punimeve është bërë në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli III, pika 2 germa ç, si dhe Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, ku vlera e objektit të dëmtuar sipas zërit të mëposhtëm është **96.000** lekë (nëntëdhjetë e gjashtë) sipas tabelës së poshtëshënuar:

Nr	Nr.An	Përshkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	227	Çati me tjegulla mars, K.D, h.d-6 mm lluster/pa lluster	m ²	40	2400	96.000
Shuma						96.000

Komisioni:

Valjeta Nikaj

Lazer Gjergji

Ardian Firza



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Numri i praktikës: 72
Vau Dejës, me: 14/01/2025

KËRKESË

Unë i/e nenshkruari/a Xhevahir Gjoka me numër personal H70519091L, banues në Vau Dejes Njësia Administrative Vau Dejës, dhe numer celulari , në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i drejtohem Sektorit të Emergjencave Civile të Bashkisë Vaut Dejës me kërkesën e mëposhtme;

KËRKOJ

Kerkoj demshperblim per prishjen e çatise se shtepise nga era e forte e ketyre diteve.

Aplikanti

Xhevahir Gjoka

Specialisti i Zyrës me Një Ndalesë

Fatjona Paloka

Përgjigjia do të merret sipas afatit ligjor jo me vonë se 10 ditë pas kryerjes së kërkesës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Nr. 373 Prot

Dt. 22.01/2025

URDHËR
Nr. 31 datë 22.01/2025
Për "Ngritje komisioni"

Mbështetur në ligjin Nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.1185/1 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të Emergjencave Civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", i ndryshuar, për verifikimin e rasteve të dëmtimit nga ererat e forta të dt.12.01.2025 në banesën e shtetasve **Xhevahir Gjoka, Liza Nika, Age Kola** banorë të Qytetit Vau Dejes, Nenshat të Njësisë Administrative Vau Dejes, Hajmel dhe sipas kërkesave me nr. praktike 72, 76 dt.14.01.2025 dhe 106 dt.16.01.2025.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit të mëposhtëm për verifikimin e e rastit të dëmtimit nga zjarri të banesave të shtetasve **Xhevahir Gjoka, Liza Nika, Age Kola** banorë të qytetit Vau Dejes, fshatit Nenshat të Bashkisë Vau-Dejës:
 - a. Valjeta Nikaj Kryetare
 - b. Fazër Gjergji Anëtar
 - c. Ardian Firza Anëtar
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri komisioni i lartpërmendur.
3. Afati për përpilimin e proces verbaleve të konstatimit dhe të vlerësimit të rasteve është data / 01/ 2025.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi
Valjeta NIKAJ

KRYETARI

SHKRELI



